

VENDIM
Nr. 234, datë 24.4.2025

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË NJË PJESE
TË PASURISË NR. 77, ZONA KADASTRALE 2380, ME VENDNDODHJE NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE DAJT, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
219, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PJESSHME (PJESA E PARË + PJESA E DYTË) TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË NJËSISË ADMINISTRATIVE TIRANË,
BASHKIA TIRANË, TË QARKUT TË TIRANËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të një pjese të pasurisë nr. 77, zona kadastrale 2380, me vendndodhje në njësinë administrative Dajt, sipas formularit dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur për realizimin e funksioneve të shërbimit funeral.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

3. Bashkia Tiranë të plotësojë kushtet teknike, që lidhen me linjën e tensionit të lartë, dopjo qark, L 220-5/6 (Tirana 1 – Elbasan 1) dhe me shtyllën nr. 19, si më poshtë vijon:

- a) në bazamentin e shtyllës plus 2 (dy) m të mos kryhen punime;
- b) në distancën 6 (gjashtë) m me përcjellësin anësor të linjës të mos ndërtohen objekte shërbimi;
- c) të sigurohet rrugë aksesit deri në bazamentin e shtyllës për operimin dhe shfrytëzimin e linjës.

4. Bashkisë Tiranë i ndalohet ndryshimi i destinacionit, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim të të tretëve të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia: Tiranë Fusha e perdorimit te Prones: Sherbim funeral				Identifikoi: Raif Halidini (Pergjegjesi Sektori) <i>HP</i> Majlinda Metani (Specialist) <i>MB</i> Mimoza Leka: Drejtor (Drejtoria e Shpronësimit e Inventarizimit dhe Zhvillimit të Pronës) <i>GL</i> Supervizori: Alban Dokushi: Drejtor (Drejtoria e Pergjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit) Alban Dokushi: Sekretar i Pergjithshëm (i Deleguar) Aprovoi: Erion Vellaj (Kryetar) <i>EV</i>						
A				B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2380 K-34-88- (253-A)	77	Ullishte	Varreza Fshati Lanabregas, Nj Ad Dajt Bashkia Tiranë	4200		Shërbime funerale	Bashkia Tirane	Bashkia Tirane	Vol.2, fq. 145 shtet



